



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 1880 Prot.

Korçë më 17.11.2022

VENDIM Nr. 537

Bazuar në shkresat e MAS (4260/1 prot., datë 01.07.2022, si dhe 4673 prot., datë 13.07.2022 "Mbi përzgjedhjen e anëtarit të bordit të administrimit, përfaqësues i studentëve"), si dhe kërkesës së Rektorit të Universitetit "Fan S. Noli" nr. 1171/1 prot., datë 16.11.2022, në Rregulloren për Organizimin e Zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në UNIKO si dhe VKM-në nr. 782, datë 26.12.2018, "Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të bordit të administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë"

VENDOSI:

- 1- Të shpallë afatet e kandidimit për organin drejtues **ANËTAR BORDI ADMINISTRIMI** "që votohet nga studentët", nga data **17 nëntor deri në datën 12 dhjetor 2022**
- 2- Të interesuarit që plotësojnë kriteret bashkëngjitur vendimit duhet të dorëzojnë në protokollin e Universitetit "Fan S. Noli" (në godinën e Rektoratit) deri në datën **12 dhjetor 2022** dokumentacionin sipas listës bashkëngjitur vendimit.
- 3- Zgjedhjet për organet drejtuese **ANËTAR BORDI ADMINISTRIMI** "që votohet nga studentët" do të zhvillohen në datën **19 DHJETOR 2022**.

Komisioni Institucional Zgjedhor

- Dr. Evjonda Pylli (Kryetar)
- Dr. Marijon Pano (Anëtar)
- Dr. Klaudia Lipi (Anëtar)
- Msc. Katerina Pikuli (Anëtar)
- Kostika Vasili (Anëtar) (Student)



Kriteret për kandidim:

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të ketë zotësi për të vepruar.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.
- Të mos ketë marrë masën disiplinore të largimit nga detyra në institucionet ku ka qenë i punësuar.
- Të mos jetë i dënuar penalisht, me vendim gjyqësor të formës së prerë ose të jetë dhënë masë sigurie apo dënim jo përfundimtar për kryerjen e krimeve në përputhje me parashikimet e ligjit nr 138/2015.
- Të jetë person me integritet etik dhe profesional, me profil publik dhe arritje të shquara brenda apo jashtë vendit në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike.
- Të ketë të paktën 10 vjet përvojë pune në fushat e mësipërme.
- Të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake.
- Të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-sigurimit të shtetit para 2 korrikut të vitit 1991.
- Të njohë të paktën një gjuhë të huaj.
- Të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore

Dokumentet për kandidim:

- Kërkesë për aplikim ku të jetë specifikuar IAL ku kandidon;
- Jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe (CV);
- Fotokopje e diplomës (përfshirë dhe atë Bachelor), për diplomat e huaja të përcillet vërtetimi i njohjes dhe njehsimit të diplomës të lëshuar nga strukturat përgjegjëse;
- Fotokopje e ID;
- Fotokopje e librezës së punës;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim i lëshuar nga gjykata;
- Vetëdeklarimet sipas shtojcës së këtij vendimi;
- Vetëdeklarim që nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-sigurimit të shtetit para 2 korrikut të vitit 1991.



SHTOJCA 1

SHTOJCA NR. 1/1

Vetëdeklarim mbi mosangazhimin në funksione drejtuese partiake

Deklaruesi: _____
Unë, i nënshkruari _____, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionet publike të arsimit të lartë, deklaroj se _____ i angazhuar në funksione drejtuese partiake.
Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.
Datë _____
Nënshkrimi _____

SHTOJCA NR. 1/2

Vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit

Deklaruesi: _____
Unë, i nënshkruari _____, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionet publike të arsimit të lartë, deklaroj se _____ në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, dhe legjislacioni në fuqi, për të ushtruar këtë detyrë.
Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.
Datë _____
Nënshkrimi _____

SHTOJCA NR. 1/3

Vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati

Unë, i nënshkruari _____, kandidat në procesin e konkurrimit për anëtar bordi në institucionet publike të arsimit të lartë, autorizoj Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.
Datë _____
Nënshkrimi _____

